




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 108, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 4, paragrafi 1, nën[paragrafi 1.27 të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me qëllim të unifikimit të taksave gjyqësore, në mbledhjen e mbajtur me datë 15 mars 2017, miraton:

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 01/2017 PËR  
UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE**

**Neni 1  
Qëllimi**

- 1.1 Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen taksat gjyqësore (në tekstin e mëtejme: taksa) në procedurat që zhvillohen në Gjykatat e Republikës së Kosovës, si dhe mënyra e pagesës së tyre.
- 1.2 Mënyra e pagesës së taksave dhe lartësia e taksave për parashtresa caktohen me tarifën e taksave në përputhje me nenin 12 dhe 13 të këtij Udhëzimi.

**Neni 2  
Përkufizimet**

- 2.1 “Gjykatë” ose “gjykata” do të thotë Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme e Kosovës, përfshirë këtu edhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtimin ankesave pronësore kundër vendimeve të Agjencionit Kosovar të Pronave (AKP).

- 2.2 “Taksë” do të thotë çfarëdo takse e përmendur në nenin 12 dhe 13 nga listat e Tarifës për taksat gjyqësore.
- 2.3 “Palë” do të thotë personi që dorëzon padinë, kundërpadinë, ankesën ose çfarëdo parashtrese tjetër që dorëzohet në gjykatë.
- 2.4 “Parashtresë” do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për përmbarim,
- 2.5 propozim për caktimin e masës së sigurimit, etj.
- 2.6 „Vendim” do të thotë aktgjykim apo aktvendim i marrë nga gjykata kompetente.
- 2.7 “TTGJ” do të thotë Tarifa për taksat gjyqësore.
- 2.8 “KGJK” do të thotë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- 2.8 “SKGJK” do të thotë Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

### Neni 3

#### Përcaktimi i taksave për parashtresat lidhur me kërkesat civile

Përcaktimi i lartësisë së taksave gjyqësore që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtresës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit, gjegjësisht llojit të parashtresës, duke u bazuar në Tarifën për taksat gjyqësore të këtij Udhëzimi (TTGJ).

### Neni 4

#### Mënyra e pagesës së taksave

- 4.1 Taksat llogariten dhe paguhen në “Euro” si monedhë e qarkullueshme në Kosovë.
- 4.2 Taksat, të cilat nuk e tejkalojnë shumën prej 5 eurosh, paguhen me para të gatshme në arkën e gjykatës.
- 4.3 Taksat, të cilat tejkalojnë shumën prej 5 eurosh, paguhen në cilën do bankë komerciale të Kosovës, në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- 4.4 Pala, pas pagesës së taksës, është e obliguar t’ia prezantojë gjykatës fletëpagesën - si dëshmi për pagesën e saj.

- 4.5 Mjetet nga taksat gjyqësore, të paguara në para të gatshme në gjykata, duhet të dorëzohen në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- 4.6 Secila gjykatë duhet t'i dorëzojë raportet periodike për të hyrat e saj në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas udhëzimeve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- 4.7 Taksat e paguara në gjykata, do të depozitohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Neni 5

### Mbledhja e taksave dhe pasojat e mos pagesës

- 5.1 Taksa duhet të paguhet me rastin e dorëzimit të parashtresës, përveç në rastet, kur është përcaktuar ndryshe me këtë Udhëzim.
- 5.2 Me rastin e dorëzimit të parashtresave, zyrtari për pranimin e të njëjtave, duhet t'ia dorëzojë palës urdhëresën për pagesën e taksës, me numër të xhirologarisë së KGJK-së ku duhet të paguhet taksa, duke caktuar lartësinë e saj sipas TTGJ, bashkë me njoftimin se mund të kërkojë lirimin nga pagesa e saj.
- 5.3 Në rastet kur këto pagesa nuk realizohen në zyrën e pranimin të parashtresave, gjykatësi ose kryetari i trupit gjykues të cilit i është caktuar lënda, urdhëron me vërejtje të posaçme pagesën e taksës në mënyrën e paraparë me nenin 5.2 (*me njoftimin për pasojat ligjore të mospagesës së saj*), sipas vlerës së kontestit dhe parametrave tjerë të përcaktuar me TTGJ si në nenin 12 dhe 13 të këtij Udhëzimi, ose vendosë sipas kërkesës së palës për t'u liruar nga pagesa e të njëjtës, nëse ka këso kërkesë.
- 5.4 Nëse gjykatësi, të cilit i është caktuar lënda, vlerëson se palës që duhet të paguajë taksën duhet t'i jepet kohë shtesë për pagesën e saj, duhet t'ia mundësojë këtë në pajtim me nenin 6.3 të këtij Udhëzimi.
- 5.5 Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si në vijim:
  - 5.5.1 Nëse taksa për parashtresë nuk paguhet deri në datën përfundimtare sipas këtij neni dhe kur nuk ekzistojnë kushtet për librim nga detyrimi për pagesën e saj, gjykata do të hedh poshtë parashtresën me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetet e goditjes.

5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim të palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr.

## Neni 6

### Pagesa e taksës në pajtim me Tarifën për taksat gjyqësore

- 6.1 Taksa për dorëzimin e parashtresës, si në TTGJ, sipas rregullit fillimisht përcaktohet nga zyrtari për pranimin e parashtresave, e nëse kjo pagesë nuk realizohet në këtë fazë, gjyqtari gjegjësisht kryetari i trupit gjykues të cilit i është caktuar lënda do ta urdhërojë palën për pagesën e saj sipas të njëjtit parim.
- 6.2 Nëse gjyqtari i caktuar në lëndë, e përcakton vlerën e parashtresës më të madhe se sa ajo e paguar në shumën e caktuar nga zyrtari i pranimit të parashtresave, atëherë, ai (gjyqtari) do taurdhërojë palën, që të paguajë shumën shtesë, në lartësinë e shumës së paguar me pak.
- 6.3 Palës duhet t'i caktohet data deri kur ai duhet të paguajë pjesën tjetër të taksës, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e pranimit të urdhrit-vërejtjes të dhënë nga gjykatësi gjegjësisht kryetari i trupit gjykues.
- 6.4 Nëse gjyqtari i caktuar në lëndë, e përcakton vlerën e parashtresës më të vogël, në raport me taksën e paguar nga pala, atëherë, duhet të urdhërojë kthimin e diferencës së taksës, e këtë pa përfunduar procedura gjyqësore.

## Neni 7

### Bartja e kompetencës dhe tërheqja e parashtresës

- 7.1 Taksa e paguar për çështjen për të cilën një gjykatë është shpallur jo kompetente, vlen edhe për gjykatën e cila sipas ligjit është kompetente për vendosje.
- 7.2 Nëse gjykata të cilës i është dërguar çështja në kompetencë, vlerëson se taksa e paguar është më e ulët apo më e lartë nga ajo që parashihet me TTGJ, ajo e urdhëron palën që ta paguajë diferencën e taksës së paguar më pak, në afatin e përcaktuar nga ajo, por duhet edhe t'ia kthejë palës diferencën e taksës nëse ai/ajo ka paguar më shumë, e këtë pa përfunduar procedura gjyqësore.

- 7.3 Pas pagesës së taksave si gjykata që e përcjell lëndën edhe ajo që e pranon lëndën, duhet të raportojnë ashtu siç parashihet në nenin 4 pika 4.6 të këtij Udhëzimi.
- 7.4 Nëse pala tërheq parashtrësën pasi të ketë paguar taksën, ajo nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e taksës tashmë të paguar gjykatës.

## Neni 8

### Lirimi nga pagesa e taksave

#### 8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si ne vijim:

- 8.1.1 personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla
- 8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai
- 8.1.3 Familjet e dëshmorëve të UÇK dhe të zhdukurve në luftë
- 8.1.4 Invalidët e UÇK-së dhe
- 8.1.5 Familjet e viktimave civile të luftës

#### 8.2 Institucionet shtetërore (lokale dhe qendrore)

#### 8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për tu liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova:

- 8.3.1 dëshmi se ai/ajo është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës Dhen Mirëqenies Sociale
- 8.3.2 dëshmi se ai/ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra e për Ndihmë juridike falas
- 8.3.3 dëshmi mbi statusin e familjarëve të dëshmorëve të UÇK-së dhe të zhdukurve
- 8.3.4 dëshmi mbi statusin e Invalidit të UÇK-së
- 8.3.5 dëshmi mbi statusin e familjarëve të viktimave civile të luftës

#### 8.4 Gjykatësi ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga pala e cila më herët është konsideruar se i plotëson kushtet për lirim nga pagesa, që të paguajë më vonë taksën, nëse gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor vërteton se gjendja e saj financiare është

përmirësuar.

8.5 Gjykatësi apo kryetari i trupit gjykues të cilit i është caktuar lënda, mund t'i jap kohë shtesë palës e cila ka kërkuar zgjatjen e afatit të pagesës së taksës në shumën e tërësishme apo të një pjesë të saj, nëse gjenë se:

8.5.1 ajo palë nuk kualifikohet si palë që lirohet nga pagesa e taksave sipas nenit 8.1, dhe

8.5.2 se zgjatja e afatit për të paguar shumën e tërësishme ose një pjesë të taksave është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të palës.

### Neni 9

#### Parashtrësit për të cilat nuk paguhet taksa

Parashtrësit e paraqitura nga palët si ato ne vijim, lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore:

9.1 Korrigjimi, precizimi përkatësisht rregullimi i padisë;

9.2 Dërgimi i adresës së saktë;

9.3 Urgjenca për përshpejtimin e lëndës

9.4 Kërkesa për vazhdimin e procedurës së ndërprerë;

9.5 Njoftimi për caktimin apo ndërrimin e avokatit;

9.6 Parashtrësia me emrat e dëshmitarëve apo të ekspertit;

9.7 Parashtrësia për heqjen dorë nga kërkesëpadia dhe parashtrësia për tërheqje nga padia;

9.8 Parashtrësia për ndryshimin subjektiv të padisë.

9.9 Kërkesa e palës për marrjen e aktgjykimit plotësues nga gjykata

### Neni 10

#### Llogaritja e taksave për lëndët penale

Për procedurën penale të iniciuar nga prokurori i shtetit nuk paguhet taksa.

### Neni 11

#### Publikimi i informatave në lidhje me taksat

11.1 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, do t'i pajisë të gjitha gjykatat e Kosovës me nga një kopje të këtij Udhëzimi, si dhe me ndryshimet dhe plotësimet tjera eventuale të tij që mund të bëhen në të ardhmen.

- 11.2 Në secilën gjykatë, duhet të publikohen një ose më shumë lajmërime në lidhje me këtë Udhëzim bashke me TTGJ, e cila duhet të vendoset në vendet më të dukshme, ku lajmërimet mund të shihen më së miri nga personat që hyjnë në ndërtesën e gjykatës dhe kërkojnë shërbime nga zyrat për pranimin e parashtresave, ku kërkohen informata, dorëzohen dokumente, ku edhe paguhen taksat.
- 11.3 Gjykatat duhet të kenë në dispozicion kopje të mjaftueshme të këtij Udhëzimi dhe kopje të mjaftueshme të TTGJ për palët e interesuara.
- 11.4 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës do t'ia dërgojë kopjet e këtij Udhëzimi Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, Shoqatës së Avokatëve të Kosovës.
- 11.5 Ky Udhëzim dhe TTGJ-ja do të publikohen në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- 11.6 Lajmërimet në lidhje me këtë Udhëzim dhe TTGJ do të shpallen në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës.

**Neni 12**  
**Tarifa e taksave gjyqësore**

|  | <i>Artikulli</i>  | <i>Vlera e kërkesës</i>   | <i>Taksa</i>  |
|--|---|---|---|
| <i>Procedurat civile ( kontestimore dhe jokontestimore )</i> |   |   |   |
| 12.1   | Të gjitha parashtresat për të cilat është e matshme vlera, përfshirë çfarëdo rasti të ndërlidhur me borxhet monetare, pronën e luajtshme apo të paluajtshme, zhdëmtimet, kontratat me vlerë monetare, shqyrtimin e trashëgimisë dhe ekzekutimin civil të borxheve | Gjykata kompetente kur kërkesa është:<br>0 deri 1,000.00 Euro<br>1,001.00 deri 2,500.00 Euro<br>2,501.00 deri 5,000.00 Euro<br>5,001.00 deri 10,000.00 Euro<br>10,001.00 deri 50,000.00 Euro<br>50,001.00 deri 100,000.00 Euro<br>Mbi 100,000.00 Euro | 20 Euro<br>30 Euro<br>40 Euro<br>60 Euro<br>100 Euro<br>150 Euro<br>150 Euro +<br>0.5%<br>deri në<br>maksimumin<br>prej 1.000 .00<br>Euro |

|      |  |  |                    |
|------|--|--|--------------------|
|      |  |  |                    |
| 12.2 | Përveç kësaj: Të gjitha parashtresat që kanë të bëjë me ndarje fizike, rregullim mezhdash dhe sigurim provash  | Gjykata kompetente:<br>a) Propozimet<br>b) Ankesat | 30 Euro<br>30 Euro |
| 12.3 | Padi për pengim posedimi, për mbrojtje nga shqetësimi dhe për servitut   | Gjykata kompetente                                 | 50 Euro            |
| 12.4 | Padi për zgjidhjen e martesës, për besimin e fëmijëve, për alimentacion ,kontakti me fëmijët   | Gjykata kompetente                                 | 50 Euro            |
| 12.5 | Padi për vërtetimin e atësisë dhe të amësisë   |  | 50 Euro            |
| 12.6 | Dorëzimi i parashtresave për çështje statusore, përfshirë: shpalljen e personit të vdekur dhe të zhdukur, marrjen e zotësisë së veprimit, marrjen e së drejtës prindërore, dhënien e pëlqimit për lidhjen e martesës, njohjen e aktgjykimit të huaj, adoptimet, etj. | Gjykata kompetente                                 | 20 Euro            |
| 12.7 | Padi për pronësi intelektuale duke përfshirë të drejtën e autorit dhe pronën intelektuale  | Gjykata kompetente                                 | 50 Euro            |
| 12.8 | Kërkesa për ndërhyrje në procedurë.  | Gjykata kompetente                                 | 30 Euro            |
| 12.9 | Të gjitha parashtresat   | Gjykata kompetente                                 | 20 Euro            |



|                                 |  |  |  |
|---------------------------------|--|--|--|
|                                 | e tjera  |  |  |
| <i>Procedura Administrative</i> |  |  |  |
| 12.10                           | Për paditë kundër aktit administrativ ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë, Departamenti Administrativ, kur vlera e kontestit është e matshme  | 0 deri në 1.000.00 Euro<br>1,001.00 deri në 2,500.00 Euro<br>2,501.00 deri në 5,000.00 Euro<br>5,001.00 deri në 10,000.00 Euro<br>Mbi 10,000.00 Euro | 20 Euro<br>30 Euro<br>40 Euro<br>60 Euro<br>100 + 0.5 %<br>deri ne maksimumin prej 1,000.00 Euro |
| 12.11                           | Për paditë kundër aktit administrativ ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë, Departamenti Administrativ, kur vlera e kontestit është e pa matshme   |  | 50 Euro  |
| 12.12                           | Parashtresa kundër aktit administrativ që shqyrtohet ne Gjykatën Supreme   | Gjykata Supreme  | 40 Euro  |
| 12.13                           | Për ankesat kundër vendimit të shkallës së parë për propozimin për përsëritjen e procedurës, për kthimin ne gjendjen e mëparshme, kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së vendimit, revizionit |  | 40 Euro  |
| <i>Procedura penale</i>         |  |  |  |
| 12.14                           | Ankesat, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, kërkesat për rishqyrtim, kërkesat për zbutjen e jashtëzakonshme të   | Gjykata kompetente   | 40 Euro  |

|   |   |   |  |
|---|---|---|--|
|   | dënimit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme  |   |  |
| <i>Procedura kundërvajtëse</i>                |   |   |  |
| 12.15   | Kundërshtimet, ankesat propozimi për përsëritjen e procedurës, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, kthimi në gjendjen e mëparshme etj. | Gjykata kompetente                        | 10 Euro  |
| <i>Shërbimet për vërtetimin e dokumenteve</i> |   |   |  |
| 12.16   | Vërtetimi i dokumenteve për përdorim në botën e jashtme "apostili"  | Gjykata kompetente                        | 10 Euro  |
| 12.17   | Lëshimi i certifikatave – vërtetimeve të ndryshme   | Gjykata kompetente                        | 5 Euro   |
| <i>Shërbimet tjera</i>                        |   |   |  |
| 12.18   | Fotokopjimi i dokumenteve gjyqësore dhe i librave publikë të mbajtura nga gjykata   | Gjykata kompetente                        | 20 cent për faqe                                     |
| 12.19   | Ruajtja në depozitim gjyqësor   | Gjykata kompetente<br>Me vlerë të matshme | 30 Euro<br>30 Euro + 1% të vlerës për çdo vit pasues |
| 12.20   | Përpilimi i testamentit   | Gjykata kompetente                        | 40 Euro  |
| 12.21   | Ndryshimi i testamentit   | Gjykata kompetente                        | 40 Euro  |
| 12.22   | Ruajtja e testamentit   | Gjykata kompetente                        | 30 Euro  |
| 12.23   | Certifikata nga evidenca e personave kunder te cileve (nuk)   | Gjykata kompetente                        | 5 Euro   |

|       |   |  |                    |
|-------|---|--|--------------------|
|       | eshte duke u zhvilluar procedura penale dhe personave te denuar nga ajo gjykatë   |  |                    |
| 12.24 | Shikimi i dosjeve të rasteve të përfunduara<br><br><i>Verejtje: Nuk pagajné taksa personat që kanë caktuar avokat sipas detyrës zyrtare, dhe kategoria e personave te liruar me nenin 8 te ketij Udhezimi</i> | Dosjet e mbyllura deri në vitin 2000<br>Dosjet e mbyllura pas vitit 2000 | 30 Euro<br>20 Euro |
| 12.25 | Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës  |  | 30 Euro            |

Neni 13  
Tarifa e taksave Gjyqësore të Dhomës  
së Posaçme të Gjykatës Supreme

|   | <i>Artikulli</i>   | <i>Vlera e kërkesës</i>                            | <i>Taksa</i>   |
|---|--|--|--|
| <i>Procedurat Gjyqësore në Kolegjet e Specializuara (Shkalla e I)</i> |  |  |  |
| 13.1  | Paditë dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit  | Pavarësisht nga vlera e kërkesës                   | 100 Euro   |
| 13.2  | Paditë dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve për përfshirje në Listën e punëtorëve me të drejta legjitime | Pavarësisht nga vlera e kërkesës                   | 50 Euro për secilën ankesë.<br>Tarifa maksimale për një lëndë është 500 Euro.<br>Punëtorët lirohen nga pagesa e taksës |
| 13.3  | Paditë e punëtorëve për pagat e papaguara nga ana e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në procesin e privatizimit/likuidimit       | Për shumat deri në 1,000.00 Euro                   | Punëtorët lirohen nga pagesa e taksës  |
|   |  | Për shumat nga 1,001.00 Euro deri në 5,000.00 Euro | 20 Euro  |
|   |  | Për shumat nga 5.001.00 Euro e më shumë            | 30 Euro  |

|  |  |   |                                       |
|--|--|---|---------------------------------------|
| 13.4   | Paditë e përgjithshme pronësore dhe kreditore  | Pavarësisht nga vlera e kërkesës            | 100 Euro                              |
| 13.5   | Paditë dhe çështjet e tjera në lidhje me likuidimin e një ndërmarrje shoqërore   | Pavarësisht nga vlera e kërkesës            | 100 Euro                              |
| 13.6   | Paditë dhe çështjet e tjera në lidhje me riorganizimin e një ndërmarrje shoqërore  | Pavarësisht nga vlera e kërkesës            | 100 Euro                              |
| <i>Procedurat Gjyqësore në Kolegjin e Apelit (Shkalla e I I)</i> |  |   |                                       |
| 13.7   | Ankesat kundër vendime të shkallës së parë lidhur me: privatizimin, listat e punëtorëve, kërkesat pronësore-kreditore, likuidimin dhe riorganizimin e ndërmarrjeve shoqërore     | Pavarësisht nga vlera e kërkesës            | 100 Euro                              |
| 13.8   | Ankesat e punëtorëve kundër vendimeve të shkallës së parë lidhur me listat e punëtorëve me të drejta legjitime   | Pavarësisht nga vlera e kërkesës            | Punëtorët lirohen nga pagesa e taksës |
| 13.9   | Ankesat e ish - punëtorëve kundër vendimeve të shkallës së parë lidhur me pagat e papaguara nga ana e ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë në procesin e privatizimit/likuidimit | Për shumat deri në 1,000.00 Euro            | Punëtorët lirohen nga pagesa e taksës |
|  |  | Për shumat prej 1,001.00 deri 5,000.00 Euro | 20 Euro                               |
|  |  | Për shumat nga 5,001.00 Euro e më shumë     | 30 Euro                               |
| <i>Tarifat shitesë</i>   |  |   |                                       |
| 13.10  | Lëshimi i vërtetimit që ka të bëjë me një lëndë në pritje ose të kryer   | Çmimi për një vërtetim të lëshuar           | 5 Euro                                |
| 13.11  | Kopjimi i dokumenteve gjyqësore  | Çmimi për një faqe                          | 10 Centë                              |

#### Neni 14

#### Tarifa e taksave gjyqësore të Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme

Për çështjet që i adresohen Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, për shqyrtimin e ankesave pronësore kundër vendimeve të Agjencionit Kosovar të Pronave (AKP), zbatohen përshtatshëm taksat gjyqësore sipas TTGJ-së, si në nenin 12 të këtij Udhëzimi.

Neni 15  
Taksat per aktvendime dhe aktgjykime

Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ palët nuk do të paguajnë taksa gjyqësore për aktvendime dhe aktgjykime të marra nga të gjitha instancat e Gjyqësorit të Kosovës.

Neni 16  
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ NR. 2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimet e KGJK-së: KGJK. Nr.20/2012, datë 09 mars 2012, KGJK. Nr. 37/2012, datë 23 mars .2012, dhe Vendimi i KGJK-se nr.25 i datës 05 mars 2014.

Neni 17  
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi më datë 01 Maj 2017.

Prishtinë, më datë 22.03.2017

Nehat Idrizi  
Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës

